



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:107194

Datë: 19.07.2024

Numri i dokumentit: 05971506

KF.nr.531/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me Gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “International Investment Group L.L.C.me numër unik identifikues 81087906 me seli në Prishtinë, i cili përfaqësohet me autorizim nga Shoqëria e Avokatëve RPHS Law , kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës ATK në Prishtinë, me bazë juridike anulimi i vendimit, jashtë seancës, me datë 19.07.2024, morri këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTE si e pa afatshme padia e paditësit International Investment Group L.L.C, me seli në Prishtinë, e ushtruar në gjykatë me datë 28.05.2021.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me vendimin kontestues Nr.53/2021 të datës 28.01.2021 e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit me Nr.53/2021 të datës 25.03.2021 të paraqitur kundër Raportit të kontrollit të datës 23.12.2020 të lëshuar nga Administrata e Kosovës Regjioni Prishtina 3, si të pa bazuar, në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2, i Ligjit Nr.05-L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr.03L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Njoftim për Rivlerësimet e tatimit shtesë nga kontrolli.

Paditësi International Investment Group L.L.C,me seli në Prishtinë me padinë e tij të datës 28.05.2021 të paraqitur pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, ka iniciuar konfliktin administrativ në gjykatë, kundër të

paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-ATK, me të cilën ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadisë, dhe anulimin e vendimit të paditurës me Nr.53/2021 të Divizionit të Ankesave dhe e njëjta në këtë gjykatë është evidnetuar me numër A.nr.1221/21.

Në padinë e tij paditësi deklaron: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)-Divizioni i Ankesave duke vepruar në bazë të ankesës së paditësit me datën 25 mars 2021 ka marrë vendim me anë të së cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, të cilën e kishte ushtruar ndaj njoftim rivlerësimi të tatimit shtesë nga kontrolli. E paditura ka futur në kontroll tatimor paditësin me ç ‘rast objekti i kontrollit ka qenë tatimi për vlerën e shtuar për periudhën 03/2019 dhe TAK 2019, bazuar në regjistrimet kontabël të tatim paguesit, si dhe blerje-shitjet dhe llogaritë bankare si dhe informatat e dërguara nga Drejtoria për Hetime Tatimore dhe Inteligjencë (DHTI). Sipas raporteve të kontrollit të cilat janë gjetur si të bazuar nga Divizioni i Ankesave-qarkullimi shtesë ka realizuar nga informatat e DHTI-së të cilat janë prezantuar në formë tabelare, me ç ‘rast sipas pretendimeve të DHTI-së, paditësi nuk ka deklaruar qarkullimin shtesë në vlerë prej 31,110.13 Euro, i cili qarkullim reflekton në TAK, me gjithsej tatim shtesë dhe me sanksione tatimore gjithsej 4,503,49. Raportet e rivlerësimit të cilat janë të bazuara ekskluzivisht në paraqitje tabelare të DHTI-së janë tërësisht të pabazuar për shumë arsye.

E paditura në përgjigje në padi të datës 01.02.2022 ka deklaruar se meqë paditësi ka pranuar vendimin kontestuese me datë 02.04.2021, rezulton që padia është ushtruar jashtë afatit ligjor. Me tej ka shtuar se vlerëson se vendimi kontestues i ATK-së, është plotësisht i drejtë dhe në pajtim të plot me legjislacionin tatimor në fuqi, sepse në bazë të provave që ndodhen në shkresat e lëndës dhe bazuar në dispozitat e ligjeve tatimore në fuqi, pa dyshim se e paditura ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike, mbi të cilën dhe ka zbatuar të drejtën materiale kur ka vendosur në rastin e paditësit në kontest. Andaj e paditura i propozon gjykatës ta hedhë poshtë si të ushtruar jashtë afatit ligjor ose ta refuzoj në tërësi padinë e paditësit të ushtruar ndaj aktvendimit kontestues dhe që të vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin Nr.53/2021 të datës 20.03.2021.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, lënda A.nr.1221/21 është transferuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti Administrativ-Divizioni Fiskal, për në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Divizioni Fiskal, për shqyrtim të mëtejme në bazë të kompetencës lëndore, dhe ka marrë numrin KF.nr.531/22.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të parashtruar me datë 28.06.2021, dhe shkresave tjera të lëndës, ka bërë përlogaritjen e ditëve kalendarike, dhe ka konstatuar se nuk mund të veprohet sipas kërkesëpadisë së parashtruar pasi që padia është e ushtruar jashtë afatit ligjor.

Nga data 02.04.2021 kur paditësi e ka pranuar dhe nënshkruar vendimin kontestues Nr.53/2021 të datës 20.03.2021 të Administratës Tatimore të Kosovës ATK, konform nenit 3 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-222, ka pasur të drejtën që brenda 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit kontestues, të paraqes ankesë-padi në gjykatë (provë: fletëkthesa për pranimin e vendimit kontestues nga paditësi e datës 02.04.2021).

Mirëpo nga provat e lëndës është konstatuar se paditësi nuk ka respektuar këtë afat ligjor prej 30 ditësh, por i njëjti ka lëshuar këtë afat ligjor dhe me datë 28.05.2021, më shumë se 30 ditë, ka ushtruar padi në gjykatë e cila sipas dispozitave ligjore të lartcekura është e paraqitur jashtë afatit ligjor. Kjo vërtetohet nga zarfi me të cilin është dërguar padia, përmes postës rekomande me numër R 1571519 me datë 28.05.2021.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi konform nenit 64 të LKA-së.

Nga të lartcekurat dhe konform dispozitave ligjore të nenit 81C të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 34 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit duke e hedhur poshtë padinë e paditësit si të ushtruar jashtë afatit ligjor.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.531/22, datë 19.07.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.